GEN-I Tirana Sh.p.k.
Ish-Noli Business Center, Rruga Ismail Qemali Nr. 27, Tirane, Republika e Shqiperisë
T: +386 1 58 96 400; F: +386 1 58 96 429
E: info@gen-i.eu; W: www.gen-i.eu

Enti Rregullator i Energjisë (ERE)
Z.Petrit Ahmeti, Kryetar i ERE
Bulevardi "Bajram Curri", Rruga "Viktor Eftimiu" Nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri
email: erealb@ere.gov.al

Tiranë, 10 Qershor 2025
Nr. Prot. 09/2025-ER

Lënda: Propozim për zbatimin e rregulloreve të energjisë dhe liberalizimin e Tregut Shqiptar të Energjisë

I nderuar Kryetar,

GEN-I është një tregtar dhe pjesëmarrës kryesor në treg në Evropën Lindore, me filialet e saj në disa vende të Evropës, përfshirë Shqipërinë, ku ne kemi qenë pjesëmarrës aktiv në treg që nga viti 2008. Gjatë kësaj kohe, tregu shqiptar ka kaluar disa periudha të ndryshme, veçanërisht krizën energjetike (periudha e gjendjes së jashtëzakonshme) dhe periudhën pas krizës. Me paraqitjen e kësaj shkrese në kuadër të konsultimit publik për kontratën e KESH FSHU për shitblerjen e energjisë elektrike për vitin 2025, duam të theksojmë se këto kontrata janë vetëm një pjesë e një çështjeje më të gjerë të modelit të tregut siç është aktualisht, i cili nuk është i zbatueshëm në terma afatgjatë. Prandaj, dëshirojmë të shfrytëzojmë këtë mundësi për të tërhequr vëmendjen tuaj për çështje më të gjera dhe gjithëpërfshirëse që lidhen me gjendjen aktuale të tregut shqiptar të energjisë elektrike. Në veçanti, dëshirojmë të theksojmë çështjet e bazuara në kuadrin aktual rregullator të modelit të tregut shqiptar të energjisë elektrike, të cilat sipas mendimit tonë pengojnë materialisht stabilitetin, efektivitetin dhe zhvillimin e mëtejshëm të tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe integrimin e tij me tregjet e tjera evropiane.

Duke marrë parasysh siç duhet sfidat e fundit ekstreme me të cilat përballen tregjet evropiane të energjisë, dëshirojmë të shprehim mirëkuptimin tonë se ndërhyrjet e rënda rregullatore të tregut të së shkuarës së afërt u bazuan në rrethana të jashtëzakonshme dhe u ndërmorën nga shumë vende evropiane, përfshirë Shqipërinë, për të garantuar sigurinë e furnizimit dhe funksionimin e përgjithshëm socio-ekonomik. Megjithatë, me stabilizimin gradual të kushteve të tregut dhe heqjen e gjerë të ndërhyrjeve të shtetit në tregjet e energjisë, modeli aktual rregullator shqiptar pengon realizimin e eficiencave të tregut.

Në veçanti, ne dëshirojmë të theksojmë nevojën për të hequr regjimin aktual rregullator të përkohshëm, i cili e vendos pothuajse të gjithë sasinë e energjisë elektrike të prodhuar dhe konsumuar në Shqipëri, nën mekanizma të rregulluar administrativisht të shpërndarjes dhe çmimit të operuar nga subjektet shtetërore, i cili në mënyrë efektive përjashton tregjet me pakicë dhe shumicë të energjisë elektrike dhe eliminon çdo incentivë të rëndësishme për pjesëmarrësit e tregut për të marrë pjesë në tregjet e e eregjisë elektrike shqiptare, dhe si pasojë u ndalon këtyre tregjeve funksionimin e tyre të plotë dhe normal. Si rrjedhojë, vetë modeli aktual i tregut *de facto* pengon apo edhe parandalon çdo rritje të ndjeshme të likuiditetit shqiptar të energjisë elektrike në tregun e energjisë elektrike (domethënë likuiditeti ALPEX), të cilin nga ana tjetër kuadri rregullator ekzistues e përcakton si një nga parakushtet për heqjen e modelit rregullator të tregut aktual të përkohshëm (duke qenë tjetri krijimi i një Operatori të pavarur të Energjisë së Rinovueshme - REO).

Në dritën e sa më sipër, është evidente se regjimi aktual rregullator bie ndesh me vetveten, prandaj ne me mirësjellje u sugjerojmë autoriteteve shqiptare të ndërmarrin hapa vendimtarë në këtë drejtim, përkatësisht duke vendosur shkëmbimin e energjisë elektrike ndërmjet subjekteve përkatëse shtetërore që i nënshtrohen tregtimit të tregut të hapur të energjisë elektrike dhe duke shkëputur në mënyrë efektive gamën e aktiviteteve që i janë dhënë FTL-së si e drejtë, në mënyrë që të sigurojë pozicionin e tij në të njëjtin nivel me pjesëmarrësit e tjerë të tregut dhe në veçanti të bëhet ndahet efektivisht roli i FTL nga REO.

Përmbledhja rregullatore e tregut shqiptar të energjisë elektrike

Në vitin 2016, Qeveria Shqiptare miratoi Modelin e Tregut të Synuar që kërkon nga shoqëritë shtetërore: Operatori i Sistemit të Transmetimit ("OST"), Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ("OSSH"), Furnizuesi i Sherbimit Universal sh.a. ("FSHU"), Furnizuesi i Tregut Të Lirë sh.a. ("FTL"), dhe Operatori i Energjisë së Rinovueshme ("REO")— që të blejnë dhe të shesin energji elektrike në tregun e lirë nëpërmjet tenderëve ose një burse të organizuar (ALPEX). Secili operator kishte role të përcaktuara: OST të blinte energji për humbjet në transmetim, OSSH për humbjet e shpërndarjes, FSHU për furnizimin e rregulluar dhe furnizimin e si mjet i fundit, REO të shiste energjinë e rinovueshme dhe FTL të furnizonte klientët e saj të tregut të lirë. Megjithatë, modeli varej nga nisja operacionale e ALPEX dhe nuk u zbatua.

Në vend të këtij, modeli aktual i tregut shqiptar të energjisë elektrike përbëhet nga masat e vendosura pas gjendjes së jashtëzakonshme energjetike të shpallur nga qeveria shqiptare në tetor 2021 dhe të zbatuara në bazë të VKM Nr. 456, datë 29.06. 2022 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohet ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike" (Këtej e tutje **"Akti i DSHP"**). Ky akt ka hyrë në fuqi duke shfuqizuar VKM Nr. 620, datë 22.10.2022 dhe vazhdon të zbatohet deri në ditët e sotme si masë emergjente që rregullon tregun e energjisë elektrike në mungesë të Modelit të Tregut të Synuar plotësisht të zbatuar.

Akti i DSHP përcakton detyrimet e mëposhtme thelbësore të shërbimit publik për subjektet e mëposhtme:

1. **FSHU** si furnizues universal me detyrim të imponuar, ndër të tjera, të *Shërbimit të Furnizimit Universal*;

2. **Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a. ("KESH")** si shoqëri prodhimi publik me detyrimin e imponuar, ndër të tjera, për të ofruar energjinë elektrike të prodhuar FSHU-së për qëllime të furnizimit universal, si dhe OST-së dhe OSSH-së (nëpërmjet FTL) për mbulimin e humbjeve në rrjet, si dhe për të pasur të drejtën e shitjes ose blerjes së energjisë elektrike në tregun e hapur;

3. **FTL** si furnizues publik në tregun e lirë, me detyrimin e imponuar, ndër të tjera për të blerë energjinë elektrike të prodhuar nga prodhuesit e RES [Burimet e Rinovueshme të Energjisë], ta përdorë energjinë elektrike të blerë në këtë mënyrë për qëllime të përcaktuara rregullatore (p.sh. humbjet e OSSH-së), duke iu dhënë gjithashtu e drejta për të shitur dhe blerë energji elektrike në tregun e hapur me shumicë dhe për të furnizuar konsumatorët përfundimtarë në tregun e hapur.

Mangësitë e modelit aktual njihen në mënyrë implicite nga natyra e tij e përkohshme e justifikuar në mënyrë rregullatore dhe kërkojnë shpjegim më të qartë siç parashikohet në këtë seksion.
Modeli i tregut për EE i krijuar me **Aktin e DSHP** është përcaktuar të mbetet në fuqi derisa Bursa Shqiptare e Energjisë ("ALPEX") të jetë **funksionale** (d.m.th. 12 Prill 2023) dhe ***likuide***[1]. Sipas ligjit nr.24/2023, datë 23.03.2023 "Për promovimin dhe përdorimin e energjisë nga burimet e rinovueshme" (këtej e tutje **"Ligji i rinovueshëm"**) me Nenin 30, paragrafi 5, parashikon se *"ERE duhet të kryejë një vlerësim për gatishmërinë e tregut jo më herët se 10 muaj pas krijimit të ALPEX"* mbi kritere specifike, ku kryesori është krahasueshmëria e vëllimeve të tregtuara nëpërmjet ALPEX me bursa të caktuara të BE-së që do të identifikohen nga ERE.

Në këtë drejtim, duhet theksuar se regjimi rregullator i detyrimeve të shërbimit publik, i vendosur ndaj subjekteve shtetërore sipas Aktit të DSHP, në veçanti KESH, FSHU, FTL, bie ndesh me qëllimin për lehtësimin e likuiditetit të ALPEX, pasi pjesa dërrmuese e energjisë elektrike të prodhuar në Shqipëri do të shpërndahet

[1] Neni 15 i Aktit të DSHP

dhe furnizohet për qëllime të konsumit përfundimtar nëpërmjet mekanizmave jo-tregtarë të krijuar nga Akti i DSHP, duke përjashtuar efektivisht në masë të madhe nevojën për të menaxhuar anën e ofertës dhe kërkesës në tregun (me shumicë) të energjisë elektrike. Sasitë e energjisë elektrike të shkëmbyera ndërmjet subjekteve të sipërpërmendura KESH, FTL dhe FSHU zënë afërsisht 80-85% të të gjithë energjisë elektrike të prodhuar në Shqipëri si dhe të konsumit total të energjisë elektrike në Shqipëri, ndërsa çmimet e energjisë elektrike të shkëmbyer ndërmjet këtyre subjekteve brenda modelit DSHP përcaktohen nga ndërhyrja administrative dhe nuk formohen në bazë të forcave të përgjithshme të tregut të ofertës dhe kërkesës. Për rrjedhojë, çmimet e energjisë elektrike kryesisht nuk lidhen me kushtet aktuale të tregut.
Duke marrë parasysh që tregu i hapur përfaqëson një mekanizëm ku vëllimet e tregtuara dhe formimi i çmimeve bazohen në funksionimin ekonomik që rrjedh nga ndërveprimi i ofertës dhe kërkesës, është e qartë se nën regjimin e Aktit të DSHP, ngelet shumë pak hapësirë për një përputhje të tillë tregu të ofertës dhe kërkesës nëpërmjet transaksioneve të tregut, pasi këto kryesisht shlyhen jashtë tregut në përputhje me mekanizmin e aktit të DSHP.

Për më tepër, edhe brenda gamës së "tregut të lirë" siç parashikohet nga Akti i DSHP, përkatësisht konsumatorët jashtë gamës së atyre që kanë të drejtë për shërbimin e furnizimit universal, të cilët me sa duket synojnë tua nënshtrojnë furnizimin e këtyre konsumatorëve kushteve të përgjithshme të tregut, këto shtrembërohen rëndë dhe bëhen të paefektshëm për shkak të implikimeve të të drejtës së veçantë të funksioneve të papërputhshme në FTL.

Pavarësisht përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme dhe që ALPEX është funksionale që nga prilli 2023, modeli i përkohshëm i tregut mbetet ende në fuqi dhe plotësohet periodikisht me vendimet e qeverisë shqiptare[2]. Duket qartë se arsyet e vazhdimit të modelit të përkohshëm të tregut janë se **nuk ka pasur rritje domethënëse të likuiditetit të ALPEX dhe rrjedhimisht likuiditeti i mjaftueshëm i ALPEX ende as nuk ishte vlerësuar dhe as nuk ishte krijuar.**
Për të arritur normalizimin e funksionimit të tregut, duam të vëmë në dukje dy pika kryesore që duhen plotësuar: 1) **REO të bëhet subjekt i pavarur nga FTL** dhe 2) **shkëmbimi i energjisë elektrike ndërmjet mbajtësve të detyrimeve të shërbimit publik t'i nënshtrohet tregtimit të tregut të hapur për të siguruar kushtet e kërkuara për çdo rritje domethënëse të likuiditetit të energjisë elektrike me shumicë dhe të ALPEX-it.** Ne i trajtojmë të dyja këto pika në mënyrë më të detajuar në kapitujt në vijim.

Roli i dyfishtë i FTL si Operator i Energjisë së Rinovueshme (REO) dhe furnizues i tregut të lirë
Sipas regjimit të DSHP, FTL-së i është dhënë e drejta për të vepruar gjithashtu si furnizues në tregun e lirë, përveç roleve të tjera rregullatore të caktuara, veçanërisht duke vepruar si pjesëmarrës në tregun e lirë për qëllime të prokurimit të energjisë elektrike të nevojshme për të mbuluar humbjet në rrjet dhe gjithashtu si Operator i Energjisë së Rinovueshme (REO). Duke filluar nga janari 2024, **FTL**-së i është dhënë e drejta për të furnizuar klientët e saj me teprica të energjisë së rinovueshme, me një çmim shitje të vendosur nga Asambleja e Përgjithshme e saj. Çmimi i blerjes mbetet i përafruar me atë që u paguhet prodhuesve përparësorë të burimeve të rinovueshme. Këto teprica tani përdoren fillimisht për të furnizuar **klientët e tregut të lirë të FTL**-së dhe vetëm më pas - nëse mbetet energji - ato u drejtohen **konsumatorëve të shërbimit universal**.
Prandaj FTL është aktive në prokurimin/furnizimin/shitjen e energjisë elektrike për qëllime të **shërbimit të furnizimit publik** (përfshirë ruajtjen e tepricave me KESH për përdorim në të ardhmen nga konsumatorët universalë), mbulimin e humbjeve të rrjetit për OSSH (Operatorin e Shpërndarjes) dhe për qëllime të **furnizimit të tregut të lirë**. Në të gjitha këto aktivitete, FTL merret me energjinë elektrike me çmime rregullatore dhe të rregulluara artificialisht të formuara në mënyrë të pavarur dhe mjaft të palidhura me kushtet aktuale të tregut.
Si pasojë, kushtet komerciale të tregtimit/furnizimit me energji brenda objektit të segmenteve të tregut të treguar më sipër, janë të shkëputura rëndë nga realitetet aktuale të përgjithshme të tregut, veçanërisht nga

[2] Ndryshuar me VKM Nr.46, datë 31.1.2024; Nr.337, datë 5.6.2024; Nr.118, datë 26.2.2025

tregtimi i energjisë nga FTL me çmime fikse dhe nën tregun, si që rezultojnë nga aftësia e tij (të krijuar në mënyrë rregullatore) për të blerë energji të rinovueshme qoftë si REO dhe qoftë si furnizues, si dhe të ruajë energjinë e tepërt me KESH-in, duke optimizuar kështu kostot e balancimit për të ulur më tej shpenzimet në një mënyrë të padisponueshme për pjesëmarrësit e tjerë të tregut.

Meqenëse FTL vepron si konkurrent ndaj pjesëmarrësve të tjerë të tregut në disa segmente të tregut (të lirë) të energjisë elektrike (veçanërisht si furnizues në tregun e lirë), marrëveshje të tilla e vendosin FTL-në në një pozicion ku pjesëmarrësit e tjerë të tregut nuk janë në gjendje të ofrojnë realisht energji elektrike me çmime konkurruese, dhe në këtë mënyrë mbyllin tregun, shtrembërojnë konkurrencën dhe minojnë transparencën, drejtësinë dhe zhvillimin e mëtejshëm të energjisë elektrike në Shqipëri. Këto lloj kushtesh e pengojnë përfshirjen e pjesëmarrësve të tjerë të tregut për shkak të paaftësisë së tyre për të konkurruar në mënyrë të arsyeshme dhe si rezultat zvogëlojnë likuiditetin e përgjithshëm të tregut. Duke qenë se vetëm **Operatori i Energjisë së Rinovueshme (REO)** i veçantë dhe i pavarur dhe **Tregu i Ditës Përpara (DAM)** në **ALPEX** duke qenë funksional mund të sigurojnë tregun e lirë të energjisë elektrike në Shqipëri, ne inkurajojmë fuqimisht ERE-në dhe Ministrinë që të finalizojë hapat konkretë për krijimin e REO-së të pavarur dhe të rregullojë statusin rregullator të FTL në mënyrë që t'i shkëputë plotësisht rolet e saj të shumta aktuale në mënyrë që të sigurojë përfshirjen e FTL në tregun e hapur me shumicë të energjisë elektrike bazuar në kushtet aktuale të tregut të ofertës dhe kërkesës.

Vlerësimi i likuiditetit të ALPEX-it

Modeli i tregut për energjinë elektrike i vendosur me aktin e DSHP do të jetë në fuqi deri sa a) *ALPEX të jetë funksional* (d.m.th. 12 prill 2023) **dhe** *likuid* (Neni 15.1 i aktit të DSHP).

Sipas Ligjit për nxitjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë Nr. 24/2023 ("Ligji për BRE") (Neni 30, paragrafi 5), vlerësimi i gatishmërisë së tregut të ALPEX duhet të kryhet 10 muaj pas fillimit të tij operacional. ALPEX filloi në prill 2023, që do të thotë se afati i fundit për të bërë një vlerësim ishte shkurti i vitit 2024. Pavarësisht afatit dhe që ALPEX faktikisht është funksional, asnjë vlerësim i tillë nuk është bërë (të paktën jo i shpallur publikisht) deri në datën e kësaj shkrese.

Pas përfundimit të afatit (shkurt 2024), u kryen disa aktivitete nga ERE në këtë drejtim, për shembull në dhjetor 2024 ERE nisi një konsultim publik për metodologjinë e vlerësimit të likuiditetit të ALPEX, megjithatë deri në datën e kësaj shkrese ERE ende nuk e ka miratuar ose refuzuar metodologjinë, gjë që po vonon më tej progresin e tregut.

Duhet theksuar se arsyeja kryesore dhe e qartë e mungesës së rritjes së likuiditetit të ALPEX-it bazohet në elementët e shtrembërimit dhe marrjes peng të tregut. Në veçanti, siç shpjegohet më lart roli i veprimit të FTL si konkurrent ndaj pjesëmarrësve të tjerë të tregut në disa segmente të tregut (të lirë) të energjisë elektrike (duke vepruar si furnizues në tregun e lirë), këto lloj marrëveshjesh e vendosin FTL në një pozicion ku pjesëmarrësit e tjerë të tregut nuk janë në gjendje të ofrojnë realisht energji elektrike me çmime konkurruese në tregjet shqiptare të energjisë elektrike. Kjo krijon mungesë incentivash për pjesëmarrësit e tjerë të tregut për të marrë pjesë në treg, gjë që ndikon negativisht në likuiditetin e tregut shqiptar (përfshirë ALPEX) dhe shtrembëron zbulimin e çmimeve reale të tregut dhe rrjedhimisht sinjalet e tregut, të cilat përndryshe do të ofronin një bazë më të rëndësishme për vlerësimin e investimeve të mundshme në kapacitetet energjetike. Në kushtet ekzistuese, investitorët potencialë nuk janë në gjendje të vlerësojnë funksionueshmërinë ekonomike të investimeve të tyre të mundshme, gjë që ndikon negativisht në aktivitetin investues (sektori i energjisë) në Shqipëri.

Më e rëndësishmja, pothuajse i gjithë aktiviteti i shkëmbimit/tregtimit të energjisë elektrike mbetet ose ndikohet ndjeshëm nga regjimet e rregulluara nga DSHO, dhe likuiditeti është jashtëzakonisht i kufizuar për shkak të mungesës së incentivave ekonomike dhe funsionueshmërisë për përfshirjen e pjesëmarrësve të tregut të lirë. Sipas regjimit aktual të Aktit të DSHP, pjesa dërrmuese e kërkesës dhe ofertës shqiptare për

energji elektrike (përllogaritur 83 %) po përputhet me regjimin administrativ rregullator të vendosur mjaft i mbrojtur nga realitetet aktuale të tregut. Siç është konstatuar tashmë nga ERE në raportin e saj vjetor për vitin 2023 të publikuar në prill 2024, ALPEX është aktiv, por pjesa më e madhe e likuiditetit sigurohet nga transaksionet ndërmjet dy ose më shumë shoqërive shtetërore, gjë që tregon qartë mungesën e aktivitetit të tregut të hapur të pjesëmarrësve të tjerë të tregut në tregun shqiptar, pasi për shkak të modelit aktual të tregut praktikisht nuk ka mbetur asnjë treg i hapur jashtë regjimit të dominuar nga subjekti shtetëror i mbyllur sipas DSHP. Pa hapur përputhjen e përgjithshme të ofertës dhe kërkesës për energji elektrike me tregun e hapur, nuk mund të pritet në mënyrë të arsyeshme që aktiviteti i tregut të rritet, pasi tregu i lirë jashtë gamës së regjimit të DSHP në thelb nuk ekziston.

Me këtë letër jo vetëm që i bëjmë thirrje ERE-s të kryejë një vlerësim të likuiditetit të ALPEX-it, por gjithashtu avokojmë me respekt **për marrjen e masave të duhura për të siguruar kushtet e tregut të hapur dhe në këtë mënyrë parakushtet e nevojshme për rritjen e likuiditetit në treg** – kushte që nxisin konkurrencën, tërheqin tregtarë dhe furnizues të rinj të energjisë elektrike dhe u ofrojnë pjesëmarrësve të tregut, përfshirë konsumatorët, mundësinë për të marrë pjesë në treg bazuar në interesin e tyre më të mirë ekonomik. Ne inkurajojmë zbatimin e planeve të ardhshme për APLEX-in siç theksohet në *"Tryezën e Rrumbullakët për Tregun e Energjisë dhe Pjesëmarrësit e Tregut"* më 17 Prill 2025, në veçanti që ALPEX duhet të njihet si një platformë tregu, të forcohet likuiditeti i tij dhe të promovohet aktivisht pjesëmarrja më e gjerë nga aktorët e tregut. Në veçanti, këto masa do të synojnë që të t'i përcaktojnë mbajtësit e detyrimeve të shërbimit publik si pjesëmarrës të tregut të lirë që prokurojnë dhe shesin energji elektrike në tregjet e hapura me shumicë në kushtet e përgjithshme të tregut dhe të vendosin çdo skemë mbështetëse përkatëse në mënyra të tilla që nuk ndikojnë drejtpërdrejt në formimin e çmimit të tregut me shumicë.

Pa një veprim të tillë, modeli aktual i tregut rrit rrezikun e izolimit të Shqipërisë nga përpjekjet rajonale për integrimin e energjisë dhe minimin e investimeve afatgjata në këtë sektor. Me respekt i bëjmë thirrje ERE-s, Ministrisë dhe autoriteteve përkatëse që urgjentisht të ndërmarrin hapa për hapjen e tregut, rritjen e likuiditetit dhe rivendosjen e konkurrencës, të cilat janë shtylla thelbësore për funksionimin normal të tregut të energjisë në të ardhmen në Shqipëri.

Konkluzion

Siç u shpjegua më sipër, modeli aktual i tregut shqiptar, i krijuar me aktin e DSHP, është në kontrast të ashpër me parimet e përgjithshme që mbështesin integrimin e tregjeve evropiane të energjisë elektrike – përkatësisht parimet e tregut të hapur, formimit të lirë të çmimeve (bazuar në forcat e ofertës dhe kërkesës), rregullat transparente dhe jodiskriminuese të tregut – si shtyllat kryesore të tregut të integruar evropian të energjisë elektrike siç sanksionohet në **Direktivën e BE-së 2019/944**[3], **Rregulloren EUR 2019/943**[4] dhe përfundimisht **Traktatin e Komunitetit të Energjisë** në të cilin ka aderuar Shqipëria, e cila në këtë mënyrë mori përsipër detyrimin për të siguruar, garantuar dhe miratuar kuadrin rregullator në përputhje me legjislacionin përkatës të BE-së që përcakton kuadrin ligjor themelor për funksionimin e tregjeve të energjisë elektrike.

Siç u shpjegua më në detaje më sipër, tregu shqiptar i energjisë elektrike aktualisht është i prekur nga çështje të rëndësishme strukturore, duke penguar zhvillimin e një tregu vërtet të hapur dhe konkurrues, që tërheq investime afatgjata në infrastrukturën energjetike, duke rritur sigurinë e energjisë dhe përballueshmërinë e çmimit të energjisë për konsumatorin shqiptar, që do të rezultojë nga integrimi i suksesshëm i Shqipërisë në tregun evropian të energjisë elektrike.
Në dritën e shqetësimeve të përshkruara më sipër, me respekt ne i bëjmë thirrje ERE-s, Ministrisë dhe

[3] OJ L 158, 14.6.2019, f. 54–124, me ndryshime
[4] OJ L 158, 14.6.2019, f. 54–124, me ndryshime

autoriteteve të tjera përkatëse të marrin masat e menjëhershme dhe vendimtare të nevojshme për krijimin e tregut të hapur, veçanërisht për krijimin e operatorit të burimeve të rinovueshme të energjisë **(REO) si një subjekt i veçantë dhe i pavarur**, dhe të krijohet kuadri rregullator që të sigurojë se oferta dhe kërkesa për energji elektrike po zgjidhet, nëpërmjet mekanizmit të përputhjes së tregut të hapur, i cili do të sigurojë likuiditetin e ALPEX-it.

GEN-I Tirana Sh.p.k.

Naim Isufi, MBA
Drejtori Rajonal